

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Profecia e "Unabomber" për inteligjencën artificiale: Teknologjia do të ndryshojnë shoqërinë
ADRESA	https://lapsi.al/profecia-e-unabomber-per-inteligjencen-artificiale-teknologjia-do-ndryshojne-shoqerine-i1094592
BURIMI	lapsi.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 18:10:43 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 18:08:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5ec64460e9a48b4caeba4865bbb7c0343c61f75d80623358b16f4c9474d58a3b
TEKSTI	2320bd9fdda9ce168d837a45bc22c8194652f9b98e082024aaa3bb083fbb9da9
PAMJA	45d96f313ca2fd99d5fb40cfe85d5deb9d6c8f8f8640d35aa182015c23f8ab7b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	778eb27e904c89782c81de16efc4dd7409221cf0c018db1b4f1f062b47c8f1a1
E MËPARSHMJA	39329b5ad6131e6bfc0f7ede30912884b8b8c70f44210d8e0cae66b18ba5b437
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/778eb27e904c89782c81de16efc4dd7409221cf0c018db1b4f1f062b47c8f1a1

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Profecia e "Unabomber" për inteligjencën artificiale: Teknologjia do të ndryshojnë shoqërinë




LAPSI.AL • 27 SEPTEMBER 2026



"Njeriu që bota do ta njihje si Theodore Kaczynski mori vëmendje në vitin 1978 pas shpërthimit të bombës së tij të parë rudimentare të bërë në shtëpi në Universitetin e Çikagos." Aty filloi hetimi i FBI-së për njeriun që për gati 18 vjet terrorizoi Shtetet e Bashkuara me bombat e tij të dërguara me postë, dhe të cilin autoritetet e quajtën "Unabomber".

Kur vdiq 3 vjet më parë, Ted Kaczynski ishte 81 vjeç. Ai kishte qenë në burg që nga viti 1998, kur u dënua me 4 burgime të përjetshme për kryerjen e 16 bombardimeve midis viteve 1978 dhe 1995. Këto sulme, të kryera pa një motiv të qartë ose plan të saktë, vranë 3 persona dhe plagosën 23 të tjerë.



ide



Një histori korruptimi jo dashurimi
Blendi Kajsia



Gysi, Bela, Lali, Klodi si maska të një njeriu të vetëm
Andi Bushati

MOTITIRANA

17°C

KËMBIMIEURO

91.97

aktuale

15:00

Rama lan duart me skandalin e SHISH: Çështje individuale e Vlora Hysenit me drejtësisë

22:06



Rama nis sot drejt Shqipërisë, mesazh urgjent shqiptareve nga Rinasi direkt pas kthimit




TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë

Ndique Lapsin edhe në



Me interes nga publiku





Në shtator të vitit 1995, manifesti i tij u botua në "Washington Post" dhe "New York Times", duke paralajmëruar publikun për rreziqet e teknologjisë. Pas vdekjes së tij dhe zhvillimit të inteligjencës artificiale, ky tekst tërhoqi vëmendje, duke bërë që disa ta konsideronin atë si një pionier, të aftë për të parashikuar rreziqet e teknologjisë dhe për ta imituar atë. Megjithatë, 31 vjet më parë, botimi i atij teksti ishte një autogol i pabesueshëm për të.

Njeriu që për gati 18 vjet kishte arritur të trondiste Shtetet e Bashkuara dhe t'i shpëtonte paq, u fut në kurth nga vëllai dhe kunata e tij, të cilët e njohën stilin e tij të shkruarit në manifest. Kështu mori fund "gjuetia" më e gjatë dhe më e shtrenjtë ndaj një njeriu në historinë e SHBA-së. Tashmë një film i ri, i titulluar "Unabomber", në Netflix ka rikthyer historinë e tij, e cila filloi me një diplomë në matematikë në Harvard.

Diplomimi nga Harvard në moshën 20 vjeç

Theodore John Kaczynski lindi në vitin 1942 në Çikago nga prindër të klasës punëtore, 10 vjet para vëllait të tij David. Me një IQ prej 167 (shumë mbi mesataren), Ted shpejt u bë një talent në matematikë. Fqinjët e përshkruanin atë si "inteligjent, por të vetmuar", një përshkrim që edhe shokët e tij të dhomës e ndanin gjatë viteve të kolegjit. Falë talenteve të tij, ai anashkaloi vitin e parë të shkollës së mesme dhe vitin e fundit të shkollës së mesme, duke u diplomuar në moshën 15-vjeçare.

Në moshën 16-vjeçare, falë një burse, ai filloi të ndiqte Universitetin e Harvardit, ku u diplomua në moshën 20-vjeçare, dhe më pas u regjistrua në Universitetin e Michiganit. Peter Duren, ish-profesori i tij, e përshkroi atë si një matematikan "shumë origjinal", me ide të mira dhe një punë të shkëlqyer në Berkeley, ku në moshën 25-vjeçare u bë profesor asistent, "për të nisur në një karrierë të shkëlqyer".



Në vitin 1966, në moshën 24-vjeçare, ai organizoi një takim me një psikiatër për t'iu nënshtruar tranzicionit të gjinisë, por teksa ishte në sallën e pritjes, ai ndryshoi mendje dhe diskutoi çështje të tjera gjatë seancës. Më pas, tha ai, "u ndje aq i zemëruar sa që mendoi të vriste psikiatrin dhe njerëz të tjerë që urrente", duke kujtuar atë moment si një pikë kthese.

Në vitin 1969 - papritmas dhe pa shpjegime - ai u largua nga akademia, dha dorëheqjen nga Berkeley dhe u tërhoq në Montana, në një qytet rural me vetëm 1,000 banorë.

Projekti Sekret MK-Ultra i CIA-s



Rama niset sot drejt Shqipërisë, mesazh urgjent shqiptareve nga Rinasi direkt pas kthimit



Rama sulmon dy televizione: Lavatriçe mediatike, kanë marrë peng një Prokurori



WSJ: Si e ndihmoi ambasadorja amerikane kompaninë greke të siguronte marrëveshjen 6 miliardë \$ në Shqipëri



"Vlora Hyseni dhe Ergys Agasi u njohën në Kryeministri"

Kur ishte në Harvard, Kaczynski mori pjesë për një kohë në një studim të personalitetit të kryer nga Dr. Henry Murray. Në vitin 2018, CIA zbuloi se këto takime ishin pjesë e projektit MK-Ultra.

MK-Ultra, do të zbulohet më vonë, ishte emri i koduar për një program sekret kërkimor të CIA-s për kontrollin e mendjes, të drejtuar nga Zyra e Inteligjencës Shkencore. Ai përfshinte përdorimin klandestin të shumë llojeve të drogave si LSD, si dhe metodave të tjera (të përshkruara si torturë e vërtetë), për të "manipuluar gjendjet mendore individuale dhe për të ndryshuar funksionin e trurit".

Libri "CHAOS", nga gazetari Tom O'Neill, spekulon se edhe kriminelin amerikan Charles Manson mund të ketë marrë pjesë në programin MK-Ultra. Por nuk ka dokumente të deklasifikuara për ta vërtetuar këtë.

Megjithatë është e sigurt se Kaczynski ishte një nga 22 studentët që iu nënshtruan studimit, por nuk ka prova se ai u torturua ose u drogua, edhe pse ai pretendon se e ka bërë këtë. Ai gjithashtu pretendon se programi përbëhej nga një sulm psikologjik i zgjatur dhe stresues, me studentët që mbaheshin në karrige dhe lidheshin me elektroda për të monitoruar reagimet e tyre emocionale. Sipas regjistrimeve, gjatë asaj periudhe (midis viteve 1959 dhe 1962), Kaczynski ishte "emocionalisht i qëndrueshëm".

Megjithatë, sipas avokatëve të tij mbrojtës, disa probleme emocionale dhe të "kontrollit të mendjes" që dolën më vonë mund të shpjegohen nga lidhjet me pjesëmarrjen në atë program.

Jeta në një kasolle në Montana



Në vitin 1971, pas dy vitesh në shtëpinë e prindërve të tij në Illinois, Kaczynski ndërtoi një kasolle jashtë Lincoln, një qytet i vogël në Montana, pa energji elektrike ose ujë të rrjedhshëm, dhe u zhvendos aty i vetëm. Brenda, ai vendosi një shtrat, dy karrige, disa bagazhe, një sobë me gaz dhe shumë libra. Qëllimi i tij ishte të jetonte në vetmi të plotë, deri në pikën e sabotimit - përfshirë zjarrvënien - të vendeve të ndërtimit pranë kasolles së tij.

Bombat e dërguara me postë dhe një e mbajtur në aeroplan

Nga viti 1978 deri në vitin 1995, Kaczynski dërgoi me postë ose dorëzoi bomba gjithnjë e më të sofistikuara, duke vrarë 3 persona dhe duke plagosur 23 të tjerë. Shënjestrat e tij ishin akademikë, dyqane elektronike dhe linja ajrore.

Ai dërgoi dy bombat e para në Universitetin Northwestern në Illinois. Në vitin 1978, një oficer policie universitare u plagos ndërsa në vitin 1979, një student. Të dy pësuan prerje dhe djegie të lehta. Bomba e parë mbërriti si një pako e drejtuar profesorit të inxhinierisë së materialeve Buckley Crist; e dyta ishte fshehur në një kuti purosh dhe e lënë mbi një tavolinë.

Bomba e tretë u ngarkua në fluturimin e "American Airlines" nga Çikago në Uashington D.C., më 15 nëntor 1979. Për fat të mirë, pajisja lëshoi vetëm tym, por nuk shpërtheu siç ishte planifikuar. Duke u gjendur në mes të fluturimit, oficerët e policisë u detyruan të

bënin një ulje emergjente, ndërsa 12 persona u trajtuan për thithje të tymit. Kaczynski më vonë deklaroi se ishte i lehtësuar që bomba nuk kishte shpërthyer, pasi objektivi ishte "shumë i padallueshëm".

Bomba e katërt iu drejtua Percy Wood, presidentit të United Airlines. Wood pësoi prerje dhe djegie të rënda në pjesën më të madhe të trupit dhe fytyrës. Nga viti 1981 deri në vitin 1985, ishte përsëri radha e universiteteve. Së pari, ai i drejtoi një letër-bombë një profesori të inxhinierisë elektrike në Universitetin e Utah, e cila u çaktivizua; pastaj, në vitin 1982, ai dërgoi një tjetër në Universitetin Vanderbilt në Tennessee, duke plagosur një sekretar të universitetit.

Në fund, ai dërgoi dy në Berkeley, duke plagosur një profesor (i cili pësoi djegie të rënda) dhe një student (i cili humbi shikimin e pjesshëm në syrin e majtë dhe 4 gishta). Më pas, ai dërgoi një bombë - e cila u çaktivizua - në Divizionin e Fabrikimit Boeing në Auburn, Washington, dhe një tjetër në Universitetin e Michiganit, duke plagosur një profesor dhe asistentin e tij.

3 viktimat

Vrasja e parë ndodhi në vitin 1985, kur një bombë e mbushur me gozhda dhe shrapnel shpërtheu në parkingun e një dyqani kompjuterësh në Sacramento, duke vrarë pronarin Hugh Scrutton. Ai dërgoi një tjetër bombë pako në vitin 1987, në një dyqan tjetër kompjuterësh në Salt Lake City, duke plagosur rëndë një burrë.

Më pas ai bëri një pauzë 6-vjeçare dhe ndaloi së dërguari bomba deri në vitin 1993. Ai u kthye në vitet 1990 me dy sulme brenda një jave të vetme. Bombat pako mbërritën në shtëpitë e gjenetistit amerikan Charles Epstein dhe akademikut David Gelernter. Të dy humbën disa gishta. Së fundmi, dy sulmet e fundit vdekjeprurëse: në vitin 1994, ekzekutivi i reklamave Thomas J. Mosser vdiq duke hapur një bombë me pako të dërguar në shtëpinë e tij në New Jersey, dhe në prill të vitit 1995, ai vrau Gilbert Brent Murray, president të Shoqatës së Pylltarisë së Kalifornisë.

Sipas "New York Times", Murray u shpërfytyrua aq shumë nga shpërthimi sa që familjes së tij iu lejua ta shihte vetëm nga gjunjët poshtë për një lamtumirë të fundit.

Hetimet

Duke marrë parasysh se objektivat e sulmeve të tij ishin kryesisht universitetet dhe linjat ajrore, FBI filloi ta quante me emrin e koduar UNABOM (Bombardues Universitar dhe Ajror), prandaj erdhi edhe nofka "Unabomber". Megjithatë, objektivat ishin të rastësishëm, motivet të paqarta dhe bombat ishin ndërtuar nga materiale rudimentare si copa druri, kordone llambash dhe mbetje të ndryshme... Asgjë e dobishme nuk mund t'i ndihmonte agjentët ta identifikonin atë.

Kështu, në vitin 1993, FBI vendosi një shpërblim prej 1 milion dollarësh. Linja telefonike pa pagesë e ngritur për këtë rast mori mbi 50,000 raporte. Por ndryshimi erdhi vetëm me publikimin e manifestit të tij.

Manifesti dhe "Profecitë"

Në prill të vitit 1995, Kaczynski dërgoi një manifest prej 35,000 fjalësh kundër teknologjisë dhe shoqërisë moderne në "Washington Post" dhe "New York Times", të titulluar "Shoqëria Industriale dhe e Ardhmja e saj", në të cilin ai theksoi nevojën për t'u rikthyer në një stil jetese më rural, para-industrial. Në këmbim të publikimit, autori premonte të ndalojë vrasjet.



Unabomber Manifesto

**Industrial Society
and its Future**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.